



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të neneve 12.2 shkronja d 17 shkronjat e, f dhe q të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenit 15 paragrafi 1.1 të Ligjit për mbeturinat, nr. 04/L - 06 dhe nenit 19 shkronjat e, f dhe q të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur 18 korrik 2014, miratoi këtë,

VENDIM

PËR DHËNIEN NË MIRËMBAJTJE TË HAPËSIRËS TURISTIKE NË LIQENIN E BATLLAVËS

Neni 1

Për realizimin dhe funksionalizimin e projektit : Zhvillimi, përmirësimi dhe promovimi i turizmit në liqenin e Batllavës, projekt i financuar nga Komisioni Evropian (88%) në shumë 326.685,79 € dhe Komunës së Podujevës (12%) në shumë 44.548,06 €, në kohëzgjatje 1 (një) vit, i jepet më mirëmbajtje Kompanisë Regjionale të Mbeturinave “ Pastrimi “ në Prishtinë.

Dhënia në mirëmbajtje bazohet në përmbushjen me sukses të obligimeve nga Kompania e cekur në realizimin e Pilot projektit sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës, nr. 01/125-02 të datës 27 qershor 2013.

Neni 2

Kompania bënë mirëmbajtjen e infrastrukturës si dhe pastrimin dhe bartjen e mbeturinave në gjithë hapësirën turistike.

Neni 3

Çmimet e shërbimeve

- Parkimi i automjeteve në parkingje, për:
 - Motoçikletë.....1,00 €
 - Veturë.....2,00 €
 - Kombi.....3,00 €
 - Autobus.....10,00 €

- Çadra me dy shtretër.....3,00 €

Neni 4

Bazuar se gjatë sezonit veror në liqenin e Batllavës ka fluks të madh të vizitorëve dhe krijohen mbeturina të shumta dhe me qëllim të mbrojtjes së ambientit dhe ruajtjes së resurseve natyrore Komuna, në periudhën e realizimit të këtij projekti, pajtohet që të hyrat e arkëtuara nga ofrimi i shërbimeve në hapësirën turistike të jenë të hyra të Kompanisë.

Neni 5

Zbatimin e vendimit e bëjnë Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Drejtoria e Inspeksionit.

Neni 6

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-332-61154

Podujevë,

18 korrik 2014

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**

